

VENDIM
Nr. 468, datë 22.6.2016

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH BUXHETORE PËR SHPENZIME KORRENTE,
NDËRMJET PROGRAMEVE BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2016, MIRATUAR PËR
MINISTRINË E MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 17, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2016, miratuar për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve për shpenzime korrente, ndërmjet programeve, si më poshtë vijon:

a) Programit “Përkujdesja sociale”, tit. 10430, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera (për pajisjen me dekoder, sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 480/2015 dhe specifikimeve teknike të vendimit nr. 38/2015 të Autoritetit të Mediave Audiovizive, të familjeve në nevojë, përfutuese nga skema e ndihmës ekonomike)”, t’i shtohet fondi prej 180 000 000 (njëqind e tetëdhjetë milionë) lekësh;

b) Programit “Tregu i punës”, tit. 10550, kap. 1, art. 606, “Transferta për buxhetet familjare dhe individët”, t’i pakësohet fondi prej 130 000 000 (njëqind e tridhjetë milionë) lekësh;

c) Programit “Tregu i punës”, tit. 10550, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera”, t’i pakësohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh;

ç) Programit “Përfshirja sociale”, tit. 10460, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera”, t’i pakësohet fondi prej 10 000 000 (dhjetë milionë) lekësh;

d) Programit “Arsimi i mesëm profesional”, tit. 09240, kap. 1, art. 602, “Mallra e shërbime të tjera”, t’i pakësohet fondi prej 20 000 000 (njëzet milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Edi Rama